

*Memli Shaip KRASNIQI*

### **MBI DISA PIKËPAMJE TË REJA (TË VJETRA) TË AKADEMIK DOBRICA QOSIQIT**

Libri i fundit i akademik Dobrica Qosiqit, ndryshe i njohur edhe si “atë shpirtëror i mendimit politik serb” me titull “Kosovo” (“Kosova”), paraqet vijimësinë e konceptit tradicional të politikës antishqiptare për e rreth Kosovës, dje dhe sot.

Mirëfilli dihet se shkrimtari e ideologu D. Qosiq këtu e gati një gjysmë shekulli përfaqëson ajkën e establishmentit politiko-kulturor serb, padyshim se me një ndikim të pamohueshëm në anatominë e moralit filozofiko-ideologjik të Serbisë. Dhe, rrjedhimisht nga kjo, me të drejtë pyesim: sa është funksional e i drejtë ky libër dhe a mund t’i shërbeje manuali i tij ‘Kosova’ pajtimit shqiptaro-serb? Sigurisht se, duke e lexuar “xhevahirin” e tij të ri, kujtoj që ai është larg nxitësit të afrimit, dhe shumë afër, madje të nxitësit të papërmirësueshëm të një tensionimi tjetër ndërmjet shqiptarëve e serbëve. Pra, ai bën të kundërtën, duke sajuar yrnëkun e politikës garashaniane që si bazë e kishte logjikën serbe të pansllavizmit e të gjithortodoksisë. Nga profili i një “paqedashësi” ai nuk kërkon “maksimumin” e hises në Kosovë, por “vetëm” ndarjen territoriale të “Stara Serbisë”, sepse aty ka monumente fetare serbe,<sup>1</sup> thuase ato ishin denbabaden sllave e jo bizantine, pa praninë e shqiptarëve të përkatësisë së krishtere- ortodokse të tyre këtu.<sup>2</sup>

Ky libër autobiografik, dhe pse të mos trajtohet edhe si një pamflet politik, përfshin vitet 1999-2003 dhe ka për objekt retrospektivën e një disidenti politik nga e kaluara çfarë ishte D.Qosiq. “Babai shpirtëror” i Serbisë e i serbizmit u rikthehet, pra, të bëmave “patriotike” të vitit 1968, që, gjithnjë sipas tij, ndërlidhet me “kobin” e rënies së madhe” të A.Rankoviqit. Ai kështu dekadencën e kryepolicit dhe të bashkëmendimtarit

<sup>1</sup> Dobrica Ćosić, Kosovo, Beograd 2004, 185.

<sup>2</sup> Selami Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës në shek.XIV-XVI, Tiranë 1984, 98.

të vet e përjeton rëndë, madje mjaft rëndë sa për pasojë ka "iluminizmin" e shqiptarëve në Kosovë e në hapësirat e "perandorisë jugosllave" në Ballkan. Dhe, në këtë kontekst, sipas mendimit të përjetshëm në funksion të mbrojtjes së "sërbizmit", disfata e viteve kalendarike 1966-1968 ishte tragjike,<sup>3</sup> dhe sipas tij edhe më tragjike se sa ajo e Car Lazarit në Betejën e Kosovës. D.Qosiq këtë humbje të pushtetit serb në Kosovë e përjeton si humbje të sovranitetit shtetëror, pra humbje të rastit historik për të shkelur dhunshëm mbi zverkun e shqiptarëve e në favor të proceseve politike në "Jerusalem" serb në Kosovë. Pra, për zotin D.Qosiq nuk vlen norma universale morale, karakteristikë kjo e intelektualëve të ngritur "atë që ia do vetvetes mos ia moho tjetrit".

Kreatori shpirtëror i "Memorandumit", i një dokumenti pararendës që shkeli me çizmën e vet dhunshëm mbi mvetësinë tejet të përgjysmuar të autonomisë së Kosovës, është po ai i cili e ideologjizon tejmasë Akademinë e Shkencave të Serbisë në vitin 1987. Është po ai i cili më vonë do të bëhet megjithatë i vetëkobshëm për popullin e tij "hyjnor", si dhe varmihës i federatës së atëhershme të brishtë jugosllave. Mbase ai do t'u kthehet me nostalgji viteve të disidencës patriotike, "me plot sukses" udheheq kryqëzatën e vozhdit" të tij, duke suprimuar kështu atë pak autonomi të Kosovës dhe të Vojvodinës brenda "funksionimit ideal" të pushtetit qendror në Federatë. Por, ideja e akademikut tashmë dukej të kishte perënduar dhe se autori i romanit "Dielli është larg" vërtet paralajmëroi ditë me re, pa rrezatim dielli.

"Ilaçi" i tij ishte dozë e madhe helmi që prodhoi luftëra të përgjakshme në ish-Jugosllavi, ndërsa prodhuesit e drejtpërdrejtë të tyre ishin vetë serbët. Ky ishte rezultat i "xhevahirëve" të Qosiqit: vrasjeve, përdhunimeve, spastrimeve etnike, shkatërrimeve të mëdha materiale dhe të gjitha këto në emër të një ideje: "Ku është një varr serb aty është tokë serbe". Më e keqja qëndron në faktin se ai nuk pendohet për krimet e bëra serbe. Madje, shpejt gjen eurekën e arsytimit, duke proklamuar slloganin: "Ne kemi bërë krime, por njësoj kanë bërë edhe armiqtë tanë".<sup>4</sup> Dhe, sikur e gjithë kjo është e bollshme që ai të vijojë rrugën e rrugëtimit për të gjetur mënyra e modalitete në kushte e rrethana të reja drejt jetësisimit të politikës tradicionale kundërshtiptare. Prandaj, "sihariqët" e akademikut vijnë me ngulm dhe për hir të paqes së "sinqertë" me shqiptarët, ai propozon;

a) ndarjen territoriale të Kosovës, e cila do të jetësohej, duke këmbyer popullsinë, këndeje e andej sikur ajo të ishte kope bagëtish:

<sup>3</sup> D.Qosic, Kosovo, 11.

<sup>4</sup> Po aty, 120.

b) krijimin e enklavave me të drejta sovrane, duke synuar përfundimisht federalizimin e Kosovës

c) variantin reserve-ndarjen e Veriut nga Kosova, ndërsa për Graçanicën, Deçanin dhe për Deviqin, do të kërkohej denacionalizimi (prapë përvetësim sa më i madh i tokës) i pronave kishtare dhe statusin e njejtë me atë të manastireve greke në Atos.

Dhe, për të zbatuar këtë ide, ai në rolin gjithnjë të “profetit” sugjeron të “famshmin” decentralizim në baza etnike të Kosovës, duke u munduar kështu të vënë para aktit të kryer edhe bashkësinë ndërkombëtare. Ironia këtu nuk ka fund, sepse shqiptarët as që duhet të pyetën. Sipas tij, deputetët serbë duhet të jenë ata të cilët në Parlamentin e Kosovës do të kërkonin revidimin e Komizës kushtetuese dhe federalizimin e Kosovës.<sup>5</sup> Provat e këtij dishepulli janë të “thjeshta”, pasi ato mund të gjejnë prehje në “ninullat” e Rezolutës 1244, ku theksohet se Kosova është ende pjesë e Jugosllavisë (por vetëm formalisht deri në përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës).<sup>6</sup>

Më tej, si gjithëherë në rolin e “këshillëdhënësit” përplot mesazhe prej një belaxhiu të papërmirësueshëm, ai këshillon injorimin e ngulmtë në mosrealizimin e standardeve në Kosovë, ngase ato nuk janë në përputhje me interesat afatgjata serbe. Vetvetiu, respektimi i të drejtave të pakicave dhe demokratizimi nuk janë edhe interesa të Serbisë dhe e gjithë kjo konfirmon epitetin destabilizues të establishmentit politik serb në rajon! Nuk është e rastit prandaj, që D.Qosiq del faktor frenues i çdo progresi, duke synuar kështu implementimin e metodave të vjetra serbe, pra “lot e vaj” në çdo hap e në çdo kohë, për çkado. Doemos, shqiptarët sipas tij janë “kriminelë”, tregtarë droge e armësh, dhe se këtu duhet rrahur teli për trajtimin terrorist të sjelljes se tyre. Shkurt, intelektual i kërkon gënjeshtër dhe fabrikim të argumenteve!!!!!!!

Tani t’i analizojmë argumentet serbe, një për një. Argumenti i parë: ”mbi të drejtën historike serbe në Kosovë”. Ata “dëshmojnë” se shteti mesjetar serb ka përfshirë nga shek.XIII-XV edhe territorin e Kosovës,<sup>7</sup> dhe se me këtë hapësirë janë të lidhur emocionalisht, ngase në betejën aty, më 1389, ata humbën shtetësinë, duke përjetuar kështu tragjedinë e parë etnike të tyre. Logjika e fakteve tregon se historia e Ballkanit nuk fillon me ardhjen e sllavëve në shekullin VII, dhe se në Gadishullin tonë kishte pasur civilizim të lashtë, parasllav gjithsesi.<sup>8</sup> Dhe, kush ishin bartës të asaj kulture të vjetër,

<sup>5</sup> Po aty. 198.

<sup>6</sup> Rezoluta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Njujork. 1999.

<sup>7</sup> Vladimir Nikolić-Zemunski, Istorija Cara Stevana Dušana, Beograd 1927, 123.

<sup>8</sup> Stanoje Stanojević, Istorija srpskog naroda, Beograd 1926. 38.

përveç se Ilirët, të cilët shkencë e historiografisë së djeshme e të sotme i pohon e rikonfirmon për paraardhës të shqiptarëve.<sup>9</sup> Nga kjo, sipas logjikës serbe rrjedh se “ne kemi të drejtë mbi pronësinë e tërë Ballkanit, apo së paku në hapësirën e dikurshme të Dardanisë”.<sup>10</sup> Dhe, këtu del nonsensi i parë, sepse pronësia është tek e fundit e atij që i pari ka shkëlur në të.

Argumenti i dytë ose thënë hapur, fusnota e dytë e zezë, e kapur sërish për trashëgiminë e monumenteve të kulturës religjioze të tipit të krishterizmit lindor, pra te bizantit, thuhet është e rezervuar veçse për serbët, si “mbrojtësit më të shenjtë” të ortodoksisë. Dhe tani pyesim: ‘Ku ishin shqiptarët, dhe çka ishin shqiptarët, ose një pjesë jo e vogël e tyre, në periudhën paraosmane?’

Trashëgimia kulturore ortodokse nuk është dëshmi e vazhdimësisë etnike serbe në Kosovë, ngase dihet se Ilirët ishin te krishterë, logjikisht më vonë edhe pasardhësit e tyre, shqiptarët.<sup>11</sup> Prania e ikonave ortodokse me të shenjtët sllavë në kishat dhe manastiret ortodokse në Kosovë prapë nuk është argument i pronësisë serbe të tyre, sepse përsëri ka ikona po në ato kisha të të shenjtëve ilirë, por edhe shqiptarë të epokës bizantine.<sup>12</sup> Prova tjetër se shqiptarët ishin ortodoksë me shumicë në Kosovë, është vertetuar edhe nga Selami Pulaha dhe Muhamet Tërnavë.<sup>13</sup> Rrjedhimisht, nga materiali i vjelur i tyre prej bazës burimore osmane del se shumë shqiptarë në Kosovën paraosmane dhe gjatë sundimit osman i takonin rritit greko-bizantin, të paktën deri në gjysmën e dytë të shek.XVI.<sup>14</sup> Tek e fundit, se shqiptarët edhe sot i takojnë rritit te krishterizmit lindor është diç që nuk mund të mohohet, me praninë e tyre tejet aktive në Shqipëri. Padyshim se fundamenti filozofiko-politik i “babait shpirtëror” të serbëve këtu del sa i varfër po aq edhe naiv. Sepse, nëse prania e manastireve serbe dhe vetëm serbe në Kosovë ishte dhe është aq e madhe, atëherë ç’do të kërkojnë Turqia si pasardhëse e Perandorisë Osmane. Sigurisht se në tokën e lashtë të Dardanisë ka shumë objekte të trashëgimisë islame, prandaj edhe në Kosovë do të thoshim “bujrum se edhe padishahu i juaj e kishte pasur vendin këtu dhe se këtë të drejtë duhet ta kenë turqit dhe Turqia”. Arsyeja e shëndoshe historike, megjithatë, duhet të na mësojë drejt insistimit logjik edhe për përkatësinë shqiptare të trashëgimisë kulturore ortodokso-bizantine, po aq edhe sa të besimtareve te krishterë serbe të tipit lindor.

<sup>9</sup> Aleksandër Stipçević, Ilirët, Prishtinë 1980, 9.

<sup>10</sup> Nelson Çabej, Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane, Prishtinë 1990, 112.

<sup>11</sup> Gaspër Gjini, Skopska Prizrenska Biskupija kroz stoljeća, Zagreb 1995, 29.

<sup>12</sup> Mark Krasniqi, Qëndrime e reagime IV, Prishtinë 1995, 35,138.

<sup>13</sup> Muhamet Tërnavë, Popullsia e Kosovës gjatë shek.XIV-XVI, Prishtinë 1995, 38.

<sup>14</sup> S. Pulaha, Popullsia shqiptare e Kosovës..., 58-59,62-63.

Po, për argumentin etnik: Çfarë mund të thuhet për të, ngase edhe këtu D.Qosiq hedh xhevahirët e vet. Ai dhe bashkëmendimtarët besnike të tij nuk ngurrojnë as sot dhe as që kanë ngurruar dje të shpjegojnë me sloganin “ashtu më pëlqen”. “për shumë vuajtje e krajata” të popullatës serbe, të cilat ndërlihdhen me shpërnguljen e madhe të serbëve, dhe vetëm të tyre në vitet 1683-1689.<sup>15</sup> Në këtë pikë referimi padyshim se akademiku i përmendur vëhet edhe në pozitën e falsifikatorit të rëndë të historisë.

Dhe, pse mund të thuhet kështu? Sepse patriku Černojeviq, duke u vënë në ballë të të ikurve nga Peja e nga tërë Kosova atëherë më vete merr edhe shumë shqiptarë të krishterë, kryesisht të fisit Kelmend. Prandaj, këtij “babai të letërsisë, të historisë e të mendimit politik serb” (mjerisht mungon këtë herë i “famshmi” (Qubriloviq) do t’i preferonim: “I dashur, shih pak më larg, aty diku në fushat e Sremit dhe bindu se në Hrtkovci e në Nikinci edhe sot do të gjesh shumë shqiptarë me prejardhje, të ikur nga Kosova, pikërisht në vitet e patrikut Arsenije Černojeviq”.

Vajin për Kosovën, po ky dishepull i “Serbisë së Madhe”, e shpreh me lotët reke edhe për shpërnguljet e mëdha në vitet 1968-1989, dhe posaçërisht pas vitit 1999. Dhe, prapë akademiku pohon e ripohon për popullatën shumicë serbe në Kosovën dikur” të larë me gjakun e Knjaz Lazarit e të vëllezërve Jugoviq”. Megjithatë, do t’i preferonim edhe një herë të lexojë literaturën evropiane pa paragjykime e me plot burime që bëjnë të ditur për një 10% pranie të elementit serbo-sllav në Kosovë, dhe as më shumë e as më pak. Sidoqoftë, D. Qosiq tashmë e ka dëshmuar mjeshtërisht, mjerisht të gënjeshtreve dhe të krenarisë së përditshmërisë serbe. Sepse, si mund të arsyetohet kriteri i dyfishtë, kur kihet të bëhet për Kosovën e për Vojvodinën: “Për të parën vlen vetëm kriteri historiko-trashëgimor e fetar, ndërsa për të dytën kriteri etnik sot”. “Pra, histori e politikë sa të duash” që vetëm kalem i D. Qosiqit është në gjendje ta sajojë forcën e argumentit të dështuar institucional të Serbisë.

Por, edhe këtë herë shpjegimi modern dhe pa paragjykime i historisë sikur nuk është i kapshëm edhe sot e gjithë ditën, pra është i huaj për të, para së gjithash për tragjikën në ex-territorin e Dardanisë, pastaj në Sanxhakun e Nishit dhe të kazasë së Vrajës përmes dëbimit masiv të popullatës shqiptare.<sup>16</sup> Tek e fundit, për autorin e romanit “Dielli është larg” është “fare i panjohur” ekspansioni territorial i Serbisë në Vojvodinë, po pse jo edhe

<sup>15</sup> Rade Mihaljčić, Lazar Hrebjeljanović- Istorija, Kult, Predanje, Beograd 1984, 207,209.

<sup>16</sup> Sadulla Brestovci, Marrëdhëniet Shqiptare-Serbo-Malazeze (1830-1878), Prishtinë 1983, 255.

spastrimi etnik i “folksdojçerëve”, tutje dëbimi biblik i “amauteve” për në Turqi,<sup>17</sup> si dhe turravrapi drejt kolonizimit të Kosovës e të Vojvodinës.

Dhe, do ta pyesim D. Qosiqin se çka solli më vonë miopia e establishmentit politik të “popullit hyjnor”? Padyshim lufta në Bosnjë që la mbi 200.000 të vrarë boshnjakë dhe kroatë, plus shkatërtime të mëdha materiale, duke arritur kështu skenarin e dhunës së pashembullt mu në zemër të “Kontinentit të Vjetër” luftën e përgjakshme të Kosovës 1999, me 1 milion shqiptarë të dëbuar (por të rikthyer në fund të luftës), mbi 10.000 të vrarë, 3000 të zhdukur dhe me shumë objekte të shkatërruara të kultit. Pra, faktet flasin vetë se Serbia ishte ajo që ushtroi gjenocidin dhe promovoi spastrimin etnik, dhe jo shqiptarët.

Në këtë kontekst dalin edhe shumë të dhëna të tjera që pasqyrojnë injorimin eklatant të ligjit dhe të drejtën e të tjerëve për të jetuar. Serbia dhe serbet ishin ata që imponuan modelin e tyre të imponimit e të forcës për të ardhmen e shqiptarëve dikur. Serbia kështu së pari arrin që t’i anulojë vendimet e Konferencës së Bunjajt (me të cilën Kosova i bashkohet Shqipërisë), për ti detyruar shqiptarët në Kuvendin e Prizrenit më 1945 nga të shkojnë, dhe po ajo Serbi, tani me autorësinë e Qosiqit, pikërisht imponon ndryshimet kushtetuese të marsit të përgjakshëm të vitit 1989.

Argumenti qytetërues, ç’është ky? Sipas ideologëve serbomëdhenj, vetëm serbet kanë të drejtën e nikoqirit në Kosovë apo në një pjesë të saj, sepse “ata i takojnë qytetërimit evropian” (ata janë të krishterë), ndërsa shqiptarët aziatikë (ngase shumica prej tyre janë myslimanë). Rrjedhimisht, simpatia evropiane duhet të jetë në anën e familjes së madhe serbe në Kosovë, sepse ajo “mbron vlerat e krishterizmit”<sup>18</sup> përballë “ekspansionit të shqiptarëve myslimanë”. Galeria e pikturimit të të gjitha të këqijave këtu pasurohet me lloj lloj peisazhesh nga më të këqijat, ngase Evropa e pëson nga shqiptarët. Pse? “Sepse ata janë tregtarë me lëndë narkotike, afaristë armësh e trafikantë qeniesh njerëzore, dhe posaçërisht tregtarë shembullorë me femra”. Shqiptarët rrjedhimisht nuk janë punëtorë, në vendin e tyre nuk prodhohet asgjë dhe se e tërë ekonomia e tyre mbështetet në narkomafi etj.

E vërteta, ndërkaq, është krejt tjetër. Shqiptarët mbase janë ndër etnitë e rralla ku përkatësia etnike nuk identifikohet me përkatësinë fetare. Shqiptari, qoftë i krishterë ortodoks, katolik apo mysliman, ai kudo që të jetë është dhe mbetet shqiptar. Cili komb tjetër në Ballkan e ka këtë cilësi?

<sup>17</sup> Emine Arifi-Bakalli, Konventa Jugosllavo-Turke e vitit 1938 në funksion të spastrimeve etnike të trojeve shqiptare, “Gjenocidi dhe aktet gjenocidiale të pushtetit Serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndeje, Prishtinë 1995, 159.

<sup>18</sup> D.Qosić, Kosovo, 231.

Janë po ata shqiptarë, të cilët dje e sot, por gjithësesi edhe nesër, do të flasin me krenari që dikur i kanë takuar qytetërimin evropian. Duke qenë pjesë e pandarë e tij, madje pjesë pjesë edhe pas shek.XV. Nuk duhet harruar se ilirët dikur i dhanë Romës edhe perandorë, se Papatit i ofruan shumë shërbime politike e fetare, duke i dhënë Vatikanit edhe Papë, ndërsa rënien nën pushtuesin aziatik, si dhe menyrën e jetesës së tyre e kuptuan si fatkeqësi, pra nuk e zgjodhën me dëshirën e tyre.

Nga të gjitha që u thanë, mendoj se ka mjaft hapësirë dëshmie t'i rikthehemi me të drejtë mënjësonë të lashtësisë në shumë postulate, madje-madje edhe si bartës të krishterizmit, si Shën Jeronimi-përkthyesi i Biblës (nga greqishtja në latinisht) në përdorim zyrtar edhe sot nga Kisha Katolike, apo Dardania e dikurshme areali më i fuqishëm i mbizotërimit të filozofisë së saj të re në krye me Shën Florin.<sup>19</sup> Janë këto vetëm disa nga argumente tona që i vumë në pah. Ndoshta, për aq sa ato në procesin e negociatave, mbase të vështira, do t'i bënin edhe një herë me dije, para së gjithash establishmentit politik serb se rikthimi i tyre në histori është i gabueshëm, është tendencë e historicizmit të keq, që synon imponim të dhunshëm të zgjidhjes së një problemi, i paqenë për ta. Porse, në këtë kontekst, klasa politike në procesin e bisedimeve duhet pasur parasysh edhe një segment pjekurie politike. Dhe, ajo kujtoj se duhej të ishte, krahas realizimit praktik të pavarësisë pa kushte, dëshmisë e gatishmërisë së shpirtit tonë demokratik: ai i demonstrimit të aftësisë për ofrimin e garancisë së të drejtave të pjesëtarëve të minoritetit serb në Kosovë në përputhje me standardet evropiane.

---

<sup>19</sup> G.Gjini, vep. cit., 56.



*RECENSIONE*

